



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

**VENDIM**

Nr. 1, Datë 22.07.2015

**PËR**

**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR “NDËRTIMIN E SHESHIT TË PUSIT  
‘ZVËRNECI PERËNDIMOR 1’” ME VENDNDODHJE NARTË, BASHKIA VLORË**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, nenit 19 të Vendimit nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, Vendimit nr. 877, datë 03.10.2013 të Këshillit të Ministrave “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për “Ndërtimi i sheshit të Pusit ‘Zvërneci Perëndimor 1’” me vendndodhje në Nartë, Bashkia Vlorë, me subjekt aplikues shoqërinë “San Leon Durrësi B.V” sh.p.k.
2. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:
  - a. Dokumenti i Rregullores së Lejes së Ndërtimit;
  - b. Harta e Planvendosjes së Strukturave.
3. Ngarkohet Ministria e Mjedisit në bashkëpunim me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, për:
  - a. kryerjen e procesit të kontrollit të përputhshmërisë së projektit/ndërtimit me përcaktimet e Konventës Ndërkombëtare të Ramsar-it;
  - b. hartimin e procedurës për rehabilitimin e mjedisit, ku do të ndërtohet;
  - c. monitorimin e zbatimit të kontratës, me qëllim ruajtjen dhe mosdëmtimin e mjedisit,
4. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për lëshimin e Formularit të Lejes së Ndërtimit.
5. Formulari i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Njesisë së Qeverisjes Vendore.
6. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Ministria e Mjedisit dhe Njësia e Qeverisjes Vendore për zbatimin e këtij vendimi.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**



ZËVENDËS KRYETARE E KKT

EGLANTINA GJERMENTI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



DAMIAN GJIKNURI

MINISTËR I ENERGIJË DHE INDUSTRIJË



SEKRETARE E KKT

ADELINA GRECA

DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

